



## **Analizë e Raporteve Vjetore të Agjencive të Pavarura**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

**MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK**

**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

# Analizë e Raportit Vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017

---

"Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së."

## Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore në kuadër të projektit “Promovimi dhe inkurajimi i bashkëpunimit në mes të hisedarëve si mjet për instalimin e praktikës demokratike në vendimmarrje” dhe punës mbështetëse për Komisionin parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (Komisioni) ka bërë analizimin e Raportit Vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017. Që nga viti 2012 Instituti INDEP ka përcjellë vazhdimisht punën e agjencive të pavarura në përgjithësi dhe të agjencive që i raportojnë Komisionit në veçanti.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në bazë të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i raporton Kuvendit të Kosovës si themelues i agjencisë në baza vjetore. Në bazë të këtij ligji Agjencia është e obliguar të raportojë për gjashtë elemente kryesore.

1. Bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe e bën publik raportin vjetor të Agjencisë i cili duhet të përfshijë:

- 1.1.pasqyrat financiare të llogarive të Agjencisë;
- 1.2.veçmas nga llogaritë e Agjencisë, pasqyrat financiare të llogarive dhe asetëve të cilat mbahet nga Agjencia në mirëbesim;
- 1.3.listën e ndërmarrjeve që janë vënë nën administrimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë në pajtim me nenin 6.1 të këtij ligji;
- 1.4.listën e transaksioneve të kryera sipas nenit 8 të realizuara gjatë vitit për të cilin raportohet dhe për transaksionet e mbetura pezull;
- 1.5.listën e ndërmarrjeve të likuiduara sipas nenit 9; dhe
- 1.6.listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e riorganizimit<sup>1</sup>

INDEP ka shprehur edhe më parë shqetësimin me faktin që baza e tanishme ligjore obligon AKP-në që të raportojë vetëm për këto gjashtë pika. Sidoqoftë, ky nuk ishte një problem specifik për Agjencinë e Privatizimit sepse pjesa e raportimit në Kuvend për një numër të madh të agjencive nuk është e përcaktuar qartësisht. Për këtë, Instituti INDEP në bashkëpunim po me Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri kishte hartuar Manualin për Raportim të Agjencive të Pavarura në Kuvendin e Kosovës me anë të së cilit harmonizoheshin pikat e përbashkëta të raportimit dhe specifikoheshin edhe shumëçështje të tjera si:

- Aneksë e parashtruara tek komisioni i shqyrtimit.
- Ndërmarrjet e shitura, transferuara dhe likuiduara, duke përfshirë përmbledhje të detajuara të valëve të privatizimit.
- Nivelin e “Fondit Tepricë” nëse është aplikuar në periudhën e raportimit.
- Ndërmarrjet që kanë dështuar për t’u privatizuar dhe arsyetimet përcjellëse.
- Shqiptimi i gjobave.
- Lista e asetëve të mbetura të pa privatizuara etj.<sup>2</sup>

<sup>1</sup>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, (2011), Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Neni 20, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2773> (qasur në prill, 2017)

<sup>2</sup>Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, (2014), Përfundim Nr. 04-P-232/k datë 31 mars, 2014, Prishtinë: Kuvendi i Kosovës.

Ky manual i raportimit i ishte shpërndarë përmes Zyrtarit Ndërlidhës të Kuvendit për Agjenci të Pavarrua të gjitha agjencive dhe u ishte bërë e ditur që kjo do të jetë forma zyrtare e kërkesave për raportim. Përveç kësaj, Instituti INDEP në vazhdimi ka përcjellur raportet e Agjencisë së Privatizimit. Raporti i AKP-së për vitin 2018 nuk i përmbushë në tërësi kërkesat e Manualit për Raportim të Agjencive të Pavarrura, përkunder raportit voluminoz dhe më shumë informata prapë mungonë një pjesë e konsiderueshme e informatave ose janë dhënë në mënyrë të pjesshme.

## Të gjeturat nga raporti

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka një mandat të qartë ligjor dhe “është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidikimin e ndërmarrjeve dhe asetëve të përkufizuara në këtë ligj.”<sup>3</sup>

Edhe përkunder mandatit të dhënë, AKP në këtë raport nuk ka arritë që të paraqesë një plan se kur mendohet se do të përfundohet procesi i privatizimit. Pa marrë parasyshë se perfundimi i procesit të privatizimit nuk mvaret krejtësisht nga AKP por edhe nga faktorë të jashtëm, është AKP-ja që do të duhej të paraqiste planin e sajë për përfundimin e procesit të privatizimit duke renditur rreziqet që mundën të ndikojnë në këtë plan.

Krhasimi i raportit të vitit 2017 me raportin 2016 tregon se AKP-ja në total ka në menagjim 376 asete më shumë se viti paraprak. Perderisa në vitin 2016, AKP “... ka administruar dhe kërkon të administroj (duke përfshirë asetet jashtë territorit të Kosovës) me gjithsej 3,324 asete të Ndërmarrjeve Shoqërore.”<sup>4</sup>, në vitin 2017 AKP “...ka administruar dhe kërkon të administroj (duke përfshirë asetet jashtë territorit të Kosovës) me gjithsej 3,700 asete të Ndërmarrjeve Shoqërore.”<sup>5</sup>

Asetet e reja të cilat si duket AKP i ka identifikuar dhe i ka marrë nën menagjim do të ishte e nevojshme të paraqiten në këtë raport si dhe shpjegimi se pse nuk janë identifikuar deri më tani.

Gjithashtu në faqe 16 të raportit ku tregohet numri i përgjithshëm i asetëve të shitura dhe të pashitura, numri total i asetëve nuk korespondon me numrin e 3700 asetëve që mëngjon AKP-ja sic ceket më lartë në raport por është 3,538 asete në total.

Raporti i vitit 2017 në mënyrë të njëjtë sikurse raporti i vitit 2016 asetet e pashitura i ndanë në “toka bujqësore”, “toka tjera” dhe “asete tjera” pa dhënë ndonjë shpjegim se për çfarë bëhet

Disa nga pyetjet të cilave raporti nuk u përgjigjet:

1. Cili është stadi i përmbylljes së procesit të privatizimit.
2. Përse nuk është bashkangjitur plani për realizimin e shitjes së asetëve të NSh-ve?
3. Përse nuk është paraqitur lista e ndërmarrjeve dhe asetëve që kanë mbetur pa u privatizuar
4. Në cilat zona ndodhen më së shumti ndërmarrje të pa privatizuara – a ekziston një hartë e ndërmarrjeve dhe asetëve të pa privatizuara.
5. Cilat ndërmarrje dhe asete planifikohet të privatizohen në vitin 2018.

<sup>3</sup>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, (2011), Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Neni 2, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2773> (qasur në prill, 2017)

<sup>4</sup>Agjencia Kosovare e Privatizimit, (2017), Raporti Vjetor për vitin 2016, Kreu V, Aktivitetet për Periudhën Raportuese, Shitja dhe Administrimi i Asetëve, faqe 13, Prishtinë: AKP.

<sup>5</sup>Agjencia Kosovare e Privatizimit, (2018), Raporti Vjetor për vitin 2017, Kreu V, Aktivitetet për Periudhën Raportuese, Shitja dhe Administrimi i Asetëve, faqe 30, Prishtinë: AKP.

fjalë. Është e papranueshme të përdoret termi të tjera kur me siguri ka informacione në AKP-ë se qfarë janë këto asete.

Në mungesë të paraqitjes së planit për vitin 2018 mungojnë edhe të dhënat si:

- o Lista e ndërmarrjeve që planifikohet të privatizohen në vitin vijues dhe në vitet në vijim
- o Lista e ndërmarrjeve që planifikohet të likuidohen në vitin vijues dhe në të ardhmen.

Sa i përket objekteve të lëshuara me qira raporti tregon për shumën e inkasuar në total por nuk paraqet të gjitha subjektet të cilat kanë paguar qiranë. Në listë janë vetëm disa subjekte të mëdha përkunder se shumica totale e qirasë paguar nga subjektet tjera është e madhe. Të hyrat nga qiraja për vitin 2017 janë 6,528,207 euro, nga ndërmarrjet në tranzicion dhe ndërmarrjet në likuidim, nga këto të dhëna raporti nuk na tregon se nga kush janë paguar 2,254,519 euro.

Është përgjegjësi ligjore dhe në interes publik të dihen emrat e të gjithë subjekteve që paguajnë qira në AKP sepse të qenit transparent do të eliminonte keqkuptimet lidhur me mundësitë e keqperdorimit të qirave në favor të ndonjë subjekti apo individ duke pasur parasyshë se misioni primar i AKP-së është shitja e jo përfitimi nga qiraja. Gjithashtu raporti nuk tregon se marrëveshjet për qira, kontratat e nënshkruara për sa vite janë, qe sa vite paguajnë qira dhe nuk paraqet një plan se kur do të privatizohen këto subjekte. Lista e aseteve të lëshuara me qira gjendet në web faqen zyrtare të AKP-së por nuk i është bashkangjitur raportit vjetor. Kjo listë tregon se shumica e kontratave ka skaduar në vitin 2016 apo 2017 por edhe kjo listë nuk jep detaje se a janë vazhduar këto kontrata, si është bërë perzgjedhja e qiramarrësve dhe nuk informon se është zhvillur një proces transparent. Mostransparenca në përzgjedhjen e qiramarrësve ngritë dyshime të bazuara në tërë procesin e qiradhënies së objekteve të AKP-së. Nuk është raportuar se përse këto asete ende nuk janë shitur por janë dhënë me qira. Raporti do të duhej të përmbante listën e plotë të të gjitha aseteve të lëshuara me qira si dhe statusin e tyre momental në procesin e shitjes së tyre e që është misioni primar i Agjencisë. Gjithashtu raporti është dashur që në pajtim me specifikat e ndërmarrjeve shoqërore të shpjegojë përse dhënja me qira është më e favorshme sesa shitja e tyre dhe se cilat janë kriteret në bazë të së cilave vendoset për një gjë të tillë.

Raporti nuk përfshin detaje lidhur me listën e banesave në pronësi të Agjencisë, sikurse në raportet e mëhershme të AKP-s edhe këtij raporti i mungon edhe lista e banesave të shitura, vitit të ndërtimit të tyre, lokacionit, blerësit etj. Sipas raportit janë përmbyllur 50 kontrata për blerje të banesave dhe janë pranuar 53 kërkesa të reja gjatë vitit raportues.

Problemi i mos transparencës në administrimin dhe shitjen e banesave është problem që përsëritet në të gjitha raportet e AKP-së të dorëzuara në së paku gjashtë vitet e fundit.

Pasiqë raporti si i tillë i dërgohet Kuvendit dhe duke pasur parasyshë punën dhe përgatitjen e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, raportimi i ndarë nëpër departamente përkunder se ofron shumë të dhëna është gati se e pamundur për tu kuptuar nga deputetët. Një përmbledhje disafaqëshe ku do të pasqyrohej puna e tërë agjencisë me të dhënat kryesore do të ishte mëse e nevojshme në mënyrë që më lehtë të kuptohej puna dhe efikasiteti i Agjencisë nga ata që duhet ta aprovojnë. Një raport voluminoz prej 158 faqesh, përkunder që përmban shumë informata ka edhe informata që mungojnë por më kryesorja është shumë e vështirë për deputetët që ta lexojnë të tërën dhe për më shumë që ta kuptojnë si duhet.

Sa i përket pronave të uzurpuara raporti nuk paraqet ndonjë listë të uzurpatorëve përkunder se një listë e tillë ishte bërë publike disa vite më parë. Në raport thuhet se u liruan gati në tërësi pronat e uzurpuara dhe nga 53 prona të uzurpuara kanë mbetur vetëm edhe 23 të cilat gjenden në Mitrovicën e Veriut, lista me uzurpatorë nuk është paraqitur në raport. Gjithashtu në raport nuk tregohet se sa procese gjyqësore kanë filluar kundër uzurpatorëve të prones së AKP-së. Raporti

nuk tregon numrin e padive penale që janë ngritur kunder atyere që kanë uzurpuar pronën e AKP-së edhe pasi që pronat iu janë kthyer AKP-së. Është sukses lirimi dhe kthimi i pronave të uzurpuara nga ana e AKP-së por shfrytëzimi me vite nga ana e uzurpatorëve nuk guxon të mbetet i pandëshkuar, të dhëna të tilla nuk ofrohen në këtë raport. Është e pakuptimtë nëse dikush me vite të tëra e keqpërdorë pronën publike dhe në fund AKP-ja ndahet e kënaqur vetëm me lirimi e pronës e nuk ndërmerre edhe masa ligjore ndaj tyre.

Në këtë vit AKP ka kërkuar dhe ka marrë në buxhetin e vitit 2017, 100,000 euro për shpenzime kapitale të cilat nuk i ka shpenzuar të tërat por vetëm 13,910 për furnizim me pajisje të IT-së. Sikurse dy vite më parë ky është viti i tretë radhazi që mjetet e planifikuara për investime kapitale në zyre nuk është shpenzuar pasi AKP nuk ka lëvizë në objektin e ri ndërsa mjetet e planifikuara për blerjen e makinave nuk janë realizuara pasi që blerja e tyre me vendim të qeverisë udhëhiqet nga Autoriteti Qendror i Prokurimit. Raporti nuk tregon domosdoshmerinë e blerjes së veturave në vlerën e 75,000 eurove, nuk tregon se sa vetura i ka AKP në menagjim dhe nuk tregon arsyen pse duhet të blejë të reja dhe se sa do të ndikonte kjo në ngritjen e performancës së AKP-së. INDEP insiston që buxheti të mos trajtohet thjeshtë në kuptim të ngushtë financiar të përqindjes së realizimit të tij por të ketë ndërlidhje të drejtpërdrejtë në mes të performancës financiare dhe realizimit të misionit të agjencisë. Në rastin konkret duhet të ketë ndërlidhje në mes të blerjes së makinave të reja dhe rritjes së performancës së AKP-së si dhe domosdoshmërinë e blerjes së tyre.

## **Përfundime dhe rekomandime**

Raporti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP-së) për vitin 2017 është shumë voluminoz por prapë se prapë i mungojnë shumë informata të rëndësishme. Raportitit ndër të tjera i mungojnë: plani i punës për vitin 2018, lista e uzurpatorëve, lista e qiramarrësve, lista e banesave të pashitura si dhe mungojnë informatat për paditë e ngritura ndaj uzurpatorëve.

Gjithashtu në formën si është organizuar tani, raporti është një grumbullim i raporteve të departamenteve të ndryshme të agjencisë dhe nuk ka një frymë të përgjithshme të raportimit.

Plani i përmendur katërvjeçar në raportin e vitit 2016 që presupozonte përmbylljen e procesit të shitjes së aseteve përkundër që edhe atëherë nuk kishte asnjë detaj tani nuk përmendet fare se sa është realizuar ai plan të cilin deputetet nuk e kanë parë kurrë. Kur kësaj i shtohet edhe mungesa e planit të punës për vitin 2018 përkundrazi që në raport figurojnë shpenzimet për puntorinë ku do të përgatitej plani i punës për vitin 2018, një plan i tillë nuk i është bashkangjitur raportit, kjo na bën të dyshojmë se një plan i tillë ekziston fare përderisa nuk është bërë publik.

Lista e uzurpatorëve nuk i është bashkangjitur këtij raportit, edhe pse janë liruar 30 asete dhe kanë mbetur edhe 23 të uzurpuara. Gjithashtu raporti nuk tregon se qfarë ka ndodhur me ata që i kanë uzurpuar këto objekte, sa padi janë ngritur ndaj tyre pasi që uzurpimet janë vepr penale e në këtë rast i kanë shkaktuar dëme AKP-së.

Lista e qiramarrësve nuk i është bashkangjitur raportit edhe pse një listë e tillë ekziston në web faqen zyrtare të AKP-së. Raporti nuk tregon se ka pasur transparencë gjatë qiradhënies për më shumë lista në web faqen zyrtare të AKP-së tregon se shumices së aseteve të lëshuara me qira i ka skaduar kontrata në vitin 2016 apo 2017. Raporti nuk tregon për procedurat e ndjekura të lëshimit me qira të këtyre aseteve, a kanë pasur të drejtë të konkurojnë të gjithë palet e interesuara apo kanë qenë kontrata të negociuara. Mungesa e këtyre informatave rritë dyshimin për keqperdorime në favor të subjekteve të caktuara në marrjen e këtyre objekteve me qira.

Përkunder që raportohet për disa banesa të shitura raporti nuk jep më shumë detaje lidhur me lokacionin e banesave të shitura dhe gjithashtu nuk raporton në detaje lidhur me banesat që ende nuk janë shitur, sa janë, lokacionin, a janë të uzurpuara dhe kur planifikohet të shiten banesat e mbetura.

Përkunder që numri i shitjes së ndërmarrjeve gjatë vitit 2017 ka qenë shumë më i madhë se ai i vitit 2016, në total numri i aseteve nën menagjim të AKP-së është rritur. Mungojnë informatat se si ka ndodhur një gjë e tillë, me siguri ka një shpjegim të tillë në AKP por deputetet që duhet të votojnë këtë raport duhet ta kenë të qartë se çfarë po votojnë. Nëse një trend i tillë vazhdon edhe në të ardhmen atëherë procesi i privatizimit jo që do të përfundojë brenda katër vitesh sic ceket në raportin e vitit 2016 por do të vazhdojë në pafundësi.

Marrë në tërësi raporti i AKP-së nuk është i organizuar në atë mënyrë që të ofrojë qasje të lehtë dhe informata të plota.

Raporti paralajmëron që në mungesë të mjeteve të dedikuara, AKP-ja maksimum deri në qershor të vitit 2018 do të do të ketë mjete në dispozicion për të mbuluar aktivitetet e saja operative dhe administrative. Në mënyrë që kjo situatë të tejkalohet AKP-ja sugjeron që urgjentisht të gjindet një zgjidhje si për shembull ndryshimi i nenit 21i Ligjit për AKP-në dhe rritja nga 5 në 7% e të hyrave të dedikuara. Nuk kemi një vlerësim me të detajuar se si AKP-ja ka ardhur në këtë gjendje, mosplanifikimi i mirë afatgjatë i AKP-së, ligji nuk është në rregull dhe i përshtatshëm për financimin e AKP-së apo diçka tjetër por pa marrë parasysh një situatë e tillë është dashur të parashikohet me heret dhe të ketë paralajmërim me të hershëm.

Gjithashtu përunder paralajmërimit të AKP-së në raportin e kaluar për përfundimin e mandatit të 6 anëtarëve të Bordit të AKP-së, prapë nuk është ndërmarrë asgjë në atë drejtim dhe tani AKP-ja ka mbetur pa bord dhe si i tillë jofunksional bile edhe ky raport nuk është aprovuar nga Bordi që është obligim ligjor. Mbetja e AKP-së pa bord nuk është përgjegjësi e AKP-së por e institucioneve tjera.

**Përmbajtja e Raportit të Agjencionit Kosovar të Privatizimit**

**Checklist**

		<i>Po</i>	<i>Jo</i>	<i>N/A</i>	<b>Koment</b>
<i>Forma e Përgjithshme e Raportit</i>					
<b>1</b>	<b>Përmbledhje ekzekutive</b>				
	a. Pikave kryesore të cilat elaborohen në raport	Po			
	b. Arritjet e agjencisë për vitin e raportimit	Po			
	c. Objektivat për vitin e ardhshëm		Jo		
<b>2</b>	<b>Baza Ligjore, Permiresimet dhe Veshtiresite</b>				
	a. Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të institucionit	Po			
<b>3</b>	<b>Përshkrimi i Institucionit</b>				
	a. Misioni / Vizioni dhe Kompetencat	Po			
	b. Departamente përgjegjëse për plotësimin e detyrave kryesore që i përkasin kompetencave	Po			
<b>4</b>	<b>Organizmi institucional</b>				
	a. Raportimi për organizimin e brendshëm të institucionit (bordi, ekzekutivi, deri te personeli)	Po			
	b. Puna e bordit gjatë vitit raportues	Po			
	c. Organogrami; Hapesira fizike dhe lokacionit; Deklarimi I mungeses se infrastruktures se nevojshme fizike	Po			
	d. Asetet	Po			Jo ne detaje
<b>5</b>	<b>Përshkrim i Tregut/Fushën që e mbulon institucioni</b>				
	a. Krahasimi me vitin paraprak	Po			
	b. Sfidat e vitit raportues dhe planifikimi për vitin vijues		Jo		nuk ka planifikim per vitin vijues
<b>6</b>	<b>Puna gjatë vitit paraprak</b>				
	a. Punet specifike që agjencia i ka bërë gjatë vitit raportues	Po			



	b. Detyrat dhe përgjegjësitë konform ligjit	Po			
	c. Sa janë arritur qëllimet e parapara nga viti paraprak (te arsyetohen ato qe nuk jane arritur)		Jo		nuk ka pase plan qe te krahasohet
<b>7</b>	<b>Raporti financiar</b>				
	a. Raporti i buxhetit me shpenzime	Po			
	b. Të ndahen rrogat nga mëditjet	Po			
	c. Ndikimi i buxhetit në punën e Institucionit	Po			
	d. Planifikimi / Realizimi i buxhetit	Po			
	e. Investimet kapitale	Po			
	g. Shpenzimet buxhetore në bazë të aktiviteteve	Po			
	h. Vizitat jashtë vendit, mëditje, akomodim, numri i udhëtimeve dhe personave qe kanë marrë pjesë	Po			jo te gjitha ne detaje
<b>8</b>	<b>Raportimi rreth komenteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm</b>				
	a. Tabela duhet paraqitur me komentet dhe rekomandimet e ZAP dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre nga ana e institucionit	Po			
<b>9</b>	<b>Anekset</b>				
	a. listën e ndërmarrjeve që janë vënë nën administrimin e drejtpërdrejtë	Po			
	b. listën e ndërmarrjeve të likuiduara	Po			
	c. listën e transaksioneve të kryera sipas nenit 8 të realizuara gjatë vitit	Po			
	d. listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e riorganizimit	Po			
	e. lista e aseteve të mbetura të pa privatizuara		Jo		
	f. listën e banesave në autoritet të AKP-së.		Jo		
<b>Specifikat e Raportimit</b>					
<b>10</b>	Shqiptimi i gjobave			N/A	

11	Ndërmarrjet që kanë dështuar për t'u privatizuar dhe arsyetimet përcjellëse	Po			
12	Ndërmarrjet e shitura, transferuara dhe likuiduara, duke përfshirë përmbledhje të detajuara të valëve të privatizimit	Po			Jo ne detaje per valet e privatizimit

---

"Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)."